

## **THIRRJE PËR APLIKIM / NOMINIM**

### **Çmimet dhe Mirënjohjet e OIRK-së – 2025**

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) shpall thirrje për aplikim dhe nominim për ndarjen e Çmimit “**Inxhinier i Vitit – 2025**”, për anëtarët që kanë dëshmuar profesionalizëm, etikë dhe kontribut të veçantë në fushën e ndërtimit.

**E rëndësishme:** Aplikimi duhet të bazohet kryesisht në arritje/projekt/kontribut të realizuar gjatë vitit 2025 (lejohej përmendja e përvojës paraprake vetëm si mbështetje).

**Shënim:** Në varësi të numrit dhe cilësisë së aplikimeve/nominimeve të pranuar, OIRK mund të ndajë një ose më shumë çmime/mirënjohje.

#### **1. Kush mund të aplikojë / nominojë?**

- Çdo anëtar i rregullt i OIRK-së mund të aplikojë për vete ose të nominojë një koleg.
- Mund të nominojnë edhe kompani / organizata / institucione, por kandidati i nominuar duhet të jetë anëtar i rregullt i OIRK-së.

#### **2. Kushtet minimale për kandidatët**

Kandidati duhet të:

- jetë anëtar i rregullt i OIRK-së;
- mos ketë masa disiplinore në fuqi;
- ketë kryer pagesat e rregullta të anëtarësisë;
- dorëzojë aplikimin brenda afatit.

#### **3. Dokumentacioni i kërkuar (në NJË PDF)**

Aplikimi/nominimi duhet të dorëzohet si **një dokument i vetëm PDF**, i renditur në këtë mënyrë:

1. Formular aplikimi / nominimi (me të dhëna bazë)
2. CV (maksimum 2 faqe)
3. Arsyetim i shkurtër (maksimum 1 faqe), ku përshkruhen:
  - pse kandidati e meriton çmimin/mirënjohjen;
  - arritjet kryesore gjatë vitit 2025;
  - projekti kryesor dhe roli i kandidatit (përgjegjësitë dhe kontributi konkret).

4. Dëshmi mbështetëse (sa të ketë mundësi): foto/dokumentim, raporte profesionale, certifikata, linka, publikime, media, referenca të objektit (lokacion, vit, roli).
5. Rekomandim (opsional, por i preferuar).

**Shënim:** Komisioni rezervon të drejtën e verifikimit të informatave dhe dokumenteve të dorëzuara.

#### 4. Dorëzimi i aplikimeve

Aplikimet dorëzohen në email: [info@oirk.org](mailto:info@oirk.org)

**Subjekti i emailit:** “Aplikim/Nominim – Çmimet e OIRK 2025 – [Emri Mbiemri]”

- Dokumentet duhet të jenë në **NJË PDF** të bashkangjitur.
- Madhësia totale: maksimum 20 MB.
- **Emërtimi i fajllit (rekomandohet):** OIRK\_Cmimet2025\_EmriMbiemri.pdf

#### 5. Afati i fundit

**13.02.2026, ora 16:00**

Aplikimet jo të plota ose të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

#### 6. Vlerësimi dhe përzgjedhja

Vlerësimi i aplikimeve bëhet nga një **Komision profesional për Çmime dhe Mirënjohje**, i cili cakohet nga **Bordi Drejtues i OIRK-së**, dhe vepron mbi parimet e paanshmërisë dhe profesionalizmit.

Kriteret kryesore të vlerësimit janë:

- cilësia profesionale e punës / projektit;
- ndikimi në siguri dhe cilësi në ndërtim;
- etika dhe reputacioni profesional;
- kontributi në komunitet dhe në OIRK.

**Shtesë:** Anëtarët e Komisionit që kanë konflikt interesi me ndonjë kandidat, përjashtohen nga vlerësimi i atij rasti.

Fituesit do të shpallen në **Ditën Botërore të Inxhinierëve – 4 Mars**, në ceremoninë zyrtare të OIRK-së.

#### 7. Kontakt për informata ☎ 038 606 602 ✉ [info@oirk.org](mailto:info@oirk.org)

Prishtinë, 26.01.2026

Në emër të Bordit Drejtues të OIRK-së,

Kryetari i OIRK-së

Arsim Rapuç

